



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.660/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Faton Ademi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën Vukašin Barac nga Lepasaviqi, të paraqitur kundër Anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit në Lepasaviq, për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa Vukašin Barac nga Lepasaviqi, e paraqitur kundër Anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit 1201B/01R në Lepasaviq, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

II. I NDALOHET Miloš Ivanović me numër personal [REDACTED], kryesues, Tijana Delošević, me numër personal [REDACTED], Milan Jovanović, me numër personal [REDACTED], Dušan Petronijević, me numër personal, [REDACTED], Zoran Milutinović me numër personal [REDACTED] anëtarët të Këshillit të Vendvotimit 1201B/01R në Lepasaviq, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhore për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes së vendimit.

III. REFUZOHET e pabazuar pjesa e ankesës me të cilën ka kërkuar që të përsëritet votimi, në Vendvotimin 1201B/01R në Lepasaviq.

A r s y e t i m

PZAP me datë 18.10.2021, ka pranuar ankesë nga Vukašin Barac nga Lepasaviqi, me të cilën pretendon se: me datën 17.10. 2021 në orën 18:15, kamë dalë në votime për të ushtruar të drejtën time kushtetuese për të votuar. Gjatë identifikimit u vërtetua se një person tjetër ka shkruar inicialet e mia, personalisht të miat dhe jo të dikujt tjetër. Unë besoj se e drejta ime e garantuar me kushtetutë është mohuar dhe shkelur. Dëshmi: Fotografia e listës, letër njoftimi. Me këtë kërkoj nga PZAP -ja që të shpallë votimin

në vendvotim të parregullt dhe të përsërisë votimin në vendvotimin 1201B / 01R në Leposaviq. Gjatë ngjarjes, autorët më përzunë me forcë nga qendra e votimit dhe më kërcënuan.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës provave të paraqitura nga pala ankuese, si dhe provave të siguruar nga PZAP, siç janë, Libri i votimit (libri i shënimeve në VV), Lista përfundimtare e votuesve (LPV), erdhi në përfundim se ankesa e Vukašin Barac, është e bazuar.

Paneli konform nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës, duke verifikuar vendvotimin nr. 1201B / 01R, në QNR, dhe gjeti se të njëjtat pretendime janë të bazuara. Nga rezultatet e hetimit të bërë nga ana e PZAP, lidhur me vendvotimin e cekur në ankesë, rezulton fakti se inicialet e ankuesit janë shënuar në vendin e dedikuar për nënshkrim të ankuesit, nga një person tjetër. Fakti se janë shënuar inicialet e personit tjetër në vendin e dedikuar për nënshkrim të ankuesit e vërteton edhe Procesverbali i shënimeve mbi procedurat e votimit dhe numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve në vendvotimin nr. 1201B / 01R, ku ndër të tjera theksohet se: *“në vendin e Vukašin Barac, gabimisht janë shënuar inicialet B.V në ora 17:15. Në vend të Vukašin Barac gabimisht u nënshkrua Vuk Balović. Votuesit Vukašin Barac iu është shpjeguar lidhur me gabimin e bërë, dhe iu është mundësuar që gabimi të përmirësohet. Vuk Balović ka deklaruar se ka qenë shumë i lodhur sepse në atë moment ishte ardhur nga rrugëtimi, dhe nënshkruhet më iniciale B.V. Është i vetëdijshëm se ka bërë gabim dhe pajtohet me të gjitha që u shënuan në këtë libër”.* Andaj nga të cekurat më lartë paneli e vërtetoi se është fakt i pa mohueshëm se ankesa është e bazuar dhe si rezultat i këtij lëshimi të njëjtit i është mohuar e drejta në votim të lirë.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, është vendosur duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat*

apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”. Gjithashtu edhe me dispozitat e nenit 74 .10 të LZP-së, me të cilin përcaktohet se: “KV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt nga KKZ-ja”. Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se anëtarët e KVV-së, në Vendvotimin 1201B / 01R në Leposaviq, kanë bërë shkelje të dispozitave të lartcekura sepse ka vepruar në mënyrë jo profesionale dhe në kundërshtim me rregullat e PZAP-së.

Në raport me pjesën refuzuese për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli j vlerëson se mospërputhja e rezultatit konstatuar si më lart nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindës se ka pas parregullsi të asaj natyre për te ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, siç është vendosur në pikën -III-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par.3 pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 660/2021 më datën 20.10.2021

Kryesuesi i Panelit
Faton Ademi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.